


---

## PROJEKTI CULTOUR



# Promovimi i Trashëgimisë Kulturore përmes Turizmit Krijues dhe të Përvojës

Rekomandime për Politika Publike

Për: Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Bashkinë e Mirditës

**Rekomandime për Politika Publike**

<b>HYRJE</b>	<b>3</b>
<b>KONTEKSTI SOCIO-EKONOMIK</b>	<b>4</b>
Të dhëna kryesore	4
Zhvillimi ekonomik	4
Turizmi në Shqipëri	6
Turizmi në Mirditë	8
<b>METODOLOGJIA</b>	<b>10</b>
<b>TRASHËGIMIA KULTURORE</b>	<b>12</b>
Politikat e Bashkimit Evropian për Trashëgiminë Kulturore	13
Konventat ndërkombëtare mbi Trashëgiminë Kulturore që janë ratifikuar nga Shqipëria	14
Kuadri ligjor i trashëgimisë kulturore në Shqipëri	15
Trashëgimia kulturore në Mirditë	17
<b>NEVOJAT DHE PRIORITETET</b>	<b>19</b>
Intervistat	19
Analiza SWOT	19
Rekomandime për përmirësimin e politikave publike	21
<b>REFERENCA</b>	<b>23</b>
<b>SHTOJCA A: LISTA E TË INTERVISTUARVE</b>	<b>25</b>

Ky dokument u hartua si pjesë e projektit “CulTour: Promovimi i trashëgimisë kulturore nëpërmjet turizmit krijues dhe të përvojës”, i cili zbatohet nga ArtKontakt dhe EcoKult dhe synon rigjallërimin e skenës artizanale dhe promovimin e siteve me rëndësi kulturore në Mirditë. Projekti CulTour zbatohet në kuadër të programit EU4Culture, financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga UNOPS në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës.

## **HYRJE**

Udhëzuesi mbi politikat publike të Mirditës ka në fokus zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm mbështetur në trashëgiminë kulturore, veçanërisht potencialet në zonat me trashëgimi kulturore materiale dhe jomateriale, në mënyrë që të ofrojë mundësi për zhvillimin social-ekonomik lokal. Udhëzuesi ofron një përmbledhje të kontekstit socio-ekonomik, të sektorit të turizmit në Shqipëri dhe Mirditë dhe të kuadrit ligjor mbi trashëgiminë kulturore, një analizë të barrierave dhe mundësive për zhvillim të sektorit, si dhe intervista me aktorë të rëndësishëm të sektorit në këtë zonë. Qëllimi kryesor i këtij dokumenti është ofrimi i rekomandimeve praktike, të personalizuara për kontekstin, për palët e interesuara të përfshira në zhvillimin e turizmit kulturor dhe atij natyror në Mirditë. Këto rekomandime janë të hartuara për të mbështetur autoritetet vendore në përmirësimin e strategjive të tyre për ruajtjen dhe promovimin e qëndrueshëm të turizmit kulturor dhe trashëgimisë kulturore të pasur të Mirditës. Dokumenti synon të udhëzojë në krijimin e nismave që jo vetëm festojnë trashëgiminë unike të kësaj rajoni, por edhe kontribuojnë në zhvillimin socio-ekonomik të zonës. Rekomandimet përfshijnë politika afatmesme dhe afatgjata që synojnë menaxhimin e qëndrueshëm të trashëgimisë kulturore në lidhje me sektorin e turizmit, bazuar dhe në përvojat dhe sugjerimet e sektorit të zejtarisë.

## KONTEKSTI SOCIO-EKONOMIK

### Të dhëna kryesore

Sipas regjistrit të gjendjes civile, Mirdita ka një popullsi prej 37,384 banorësh. Me një sipërfaqje prej 867.1 km<sup>2</sup>, bashkia e re ka një dendësi prej 42.98 banorë/km<sup>2</sup>. Bashkia Mirditë kufizohet në veri me bashkitë e Fushë Arrëzit dhe Pukës, në perëndim me të Lezhës dhe në lindje me bashkitë e Kukësit dhe Dibrës. Në juglindje kufizohet me bashkinë Dibër, në jug me bashkinë Mat dhe në jugperëndim me bashkinë Kurbin. Bashkia përfshin 4 qytete dhe 81 fshatra, të shpërndara në 7 njësi administrative, specifikisht Rrësheni, i cili është dhe qendra urbane e bashkisë, Rubiku, Selita, Kthella, Fani, Oroshi dhe Kaçinari.

Klima është mesdhetare kodrinore, paramalore e malore. Bimët mjekësore janë mjaft të përhapura. Nga pikëpamja fizike, territori karakterizohet nga formacione malore, lugina, pllaja, fusha dhe fushëgropa. Lartësia mesatare shkon 557 m mbi nivelin e detit, ndërsa maja më e lartë është Mali i Dejës 2,121 m. Territori përshkohet nga lumenjtë Fani i Madh, Fani i Vogël dhe Uraka. Këta lumenj dhe përrenjtë e tjerë malorë kanë jo vetëm pasuri të faunës ujore, por edhe kapacitete prodhuese energjetike.

Profili ekonomik i zonës është kryesisht bujqësor dhe blegtoral. Vreshtaria po kthehet në një aktivitet mjaft të përhapur, dhe bimët mjekësore kultivohen dhe mbledhen gjerësisht. Zona ka pasuri të mëdha nëntokësore, veçanërisht bakër, pirit e krom, të cilat sollën krijimin e katër qyteteve (Rrëshen, Rubik, Kurbnesh dhe Repe) të lidhura me industrinë minerare. Aktualisht, kjo industri është më së shumti jashtë funksionit. Kjo është një nga arsyet që Mirdita shënoi një ndër nivelet më të larta të migrimit të brendshëm si dhe të emigrimit përgjatë 25 viteve të fundit.<sup>1</sup>

Gjithashtu, Mirdita njihet edhe për trashëgiminë kulturore të larmishme dhe të veçantë, me 9 monumente kulturore të kategorisë I dhe 2 monumente kulturore të kategorisë II.<sup>2</sup>

### Zhvillimi ekonomik

Nxitja e gjallërimit të potencialeve të brendshme, qasja sipas kushteve specifike, krijimi i një sistemi të integruar vlerash, përfshirja e grupeve të interesit, publike dhe private, përbëjnë disa nga parakushtet bazë për promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik në Mirditë.

---

<sup>1</sup> Bashkia Mirditë, 2016.

<sup>2</sup> Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, 2018.

Sipas të dhënave të Censurit (2011) të pasqyruara nga Bashkia Mirditë në Planin Operacional të vitit 2016, rreth 71% e bizneseve janë të vendosura në qendrën e bashkisë, në Rrëshen. Në strukturën e llojit të bizneseve, sektori i shërbimeve dominon 44% të bizneseve, ndjekur nga tregtia (37%), industria (12%) dhe ndërtimi (6%). Përqindja e vëllimit të të ardhurave të grumbulluara nga biznesi kundrejt të ardhurave të përgjithshme të Bashkisë Mirditë arrin 28%. Shkaqet për këtë shifër relativisht të ulët lidhen si me nivelin e ulët të shërbimeve të ofruara, ashtu edhe me performancën në grumbullimin e të ardhurave.

Të dhënat e INSTAT<sup>3</sup> tregojnë se lëvizje të mëdha demografike zhvendosëse, kryesisht drejt Tiranës ose jashtë vendit, kanë ndodhur në të gjithë bashkinë. Kjo ka çuar në ulje të popullsisë vendase, shifër e cila, në rang bashkie, arrin në 40.35%. Ky përkeqësim demografik reflektohet në ekonomi, në tkurrjen e konsumit, duke e ngadalësuar së tepërmi progresin e zonës. Para viteve '90, profili ekonomik i Mirditës lidhej me industrinë e shfrytëzimit të pasurive nëntokësore, kryesisht bakër, pirit, krom, dhe numri i punëtorëve në industrinë minerare arrinte në 12 000. Sot, prirjet më të larta të tkurrjes së popullsisë vihen re në vendbanimet që dikur kanë qenë të lidhura me industrinë.

Pas ndërtimit të autostradës A1, ose Rrugës së Kombit, Mirdita mori rëndësi si rrugë kalimi dhe si portë natyrore hyrëse për në Kosovë. Megjithatë, ndërtimi i Rrugës së Kombit, edhe pse përmirësoi volumin e lëvizjes dhe cilësinë e udhëtimit, nuk solli impakt domethënës për zhvillimin socio-ekonomik të zonës, që ka nevojë për impulse të reja zhvillimi.

Zhvillimi ekonomik duhet parë i lidhur ngushtë me integrimin Evropian dhe mirëqeverisjen, por në Mirditë janë të pakta nismat apo strukturat për nxitjen e zhvillimit, sidomos të zonave rurale, përveç nëpërmjet projekteve të Bashkimit Evropian dhe donatorëve të tjerë. Mirdita, si shumica e zonave me potenciale të pashfrytëzuara, përballlet me probleme socio-ekonomike edhe për shkak të kapaciteteve të pazhvilluara të burimeve njerëzore. Sot Bashkia Mirditë vuan për kapacitete në fushën e aplikimit dhe zbatimit të projekteve të financuara nga donatorë të huaj që synojnë zhvillimin e qëndrueshëm, prandaj është i nevojshëm kualifikimi dhe trajnimi i burimeve njerëzore ekzistuese si edhe rekrutimi dhe afrimi i specialistëve dhe teknicienëve të mirëfilltë në fushat që përbëjnë përparësi për ekonominë lokale.

Mirdita ka burime natyrore të mëdha; është e pasur me pyje, vendburime minerare dhe burime hidrike me potencial ujitës e hidroenergjetik. Gjithashtu, Mirdita gëzon kushte të përshtatshme

---

<sup>3</sup> Instituti i Statistikave, n.d.

klimatike dhe peizazh të bukur, çka i japin bashkisë potencial për zhvillimin e turizmit përgjatë gjithë vitit. Zona njihet edhe për vreshtarinë. Prodhimi i suksesshëm i verës nga Kantina Arbri ka nxitur fermerët vendas të shtojnë sipërfaqet e vreshtave. Kantinat mund të shërbejnë si pole zhvillimi të të gjithë territorit të bashkisë dhe të jenë në fokusin e politikave të zhvillimit rural të zonës.

Përveç burimeve të shumta natyrore, Mirdita ka edhe traditë kulturore të larmishme e unike. Trashëgimia kostumografike, muzikore, arkitektonike, orale përbëjnë një pasuri më vete. Po kështu, tradita kulinare është e veçantë dhe përfshin krijime gastronomike të trashëguara ndër shekuj, me përbërës autoktonë të zonës.

### Turizmi në Shqipëri

Pas viteve '90, u hap mundësia për turistët e huaj të vizitojnë Shqipërinë, një vend që deri atëherë kishte qenë i izoluar dhe praktikisht i panjohur. Kjo kureshtje e të huajve përbënte një faktor potencial zhvillimi për tregun e turizmit në Shqipëri i cili filloi të rritet ndjeshëm vetëm pas vitit 2010. Përmirësimi i situatës social-ekonomike ka garantuar një nivel minimal stabiliteti duke lejuar krijimin e strukturave dhe shërbimeve të reja turistike. Turistët zbuluan bukuritë e shumta natyrore dhe historike të vendit si dhe mikpritjen e vendasve. Tashmë turizmi në Shqipëri është ndër asetet strategjike të vendit. Në këto tridhjetë vjet, rritja e fluksit turistik në vend ka ardhur gjithmonë në rritje, përveç viteve 1997, 2013 dhe 2020. Sipas Ministrisë së Turizmit, në vitin 2018, mbërritjet gjithsej ishin 1,242,761, nga të cilat 766,469 nga jashtë.

- Në vitin 2019, mbërritjet gjithsej ishin 1,253,496, nga të cilat 784,709 nga jashtë.
- Në vitin 2020, mbërritjet gjithsej ranë në 665.180, nga të cilat 293.657 nga jashtë.
- Më shumë se 80% e turistëve të huaj kanë ardhur me rrugë tokësore.
- Mbi 60% e turistëve të huaj vijnë nga vendet fqinje.

Organizata Botërore e Turizmit e ka renditur Shqipërinë në vend të dytë në botë për sa i përket tendencës së fluksit turistik<sup>4</sup>. Në "Barometrin e Turizmit Botëror", me të dhënat e sektorit të turizmit në nivel global nga janari në korrik të vitit 2022, OBT konfirmon Shqipërinë me një rritje 19% krahasuar me vitin 2019, duke arritur një ndër performancat më të mira të rikuperimit të sektorit pas pandemisë".

---

<sup>4</sup> Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, 2022.

Gjatë tridhjetë viteve të fundit, kuadri legjislativ për zhvillimin e turizmit ka pësuar disa ndryshime. Realizimi i qëllimeve të mira të reformave legjislative shpesh është penguar nga vonesat dhe pasiguritë në zbatimin e tyre. Në vitin 2007, kuadri rregullator për menaxhimin e sektorit të turizmit dhe zhvillimin e standardeve për produktet dhe shërbimet turistike u përcaktua sërish. Megjithatë, kjo nismë legjislative ka gjetur pengesa të forta në mungesën e një modeli të qartë të zhvillimit ekonomik dhe në aspiratën në rritje të aktorëve ekonomikë për të vepruar lirisht në treg.

Sipas Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023<sup>5</sup>, kapitulli 2.1 Analiza e Situatës Aktuale të Sektorit të Turizmit, nga një vëzhgim i përgjithshëm i sektorit vit pas viti, turizmi po kristalizohet gjithnjë e më shumë si një ndër motorrët kryesorë të zhvillimit ekonomik të vendit. Në fakt, në Shqipëri, turizmi është një nga tre sektorët të cilët kontribuojnë më shumë në Produktin e Brendshëm Bruto (PBB). Edhe pse shifrat shpesh herë janë të paqarta dhe të ndryshme nga burimet zyrtare, bazuar në të dhënat e të njëjtit dokument:

Për vitin 2019, kontributi total i udhëtimeve turistike në Shqipëri ka qenë:

- në raport me PBB-n, 20.5% e ekonomisë totale.
- në punësim, 244 mijë të punësuar ose 21.3 % e punësimit total
- impakti në ekonomi i vizitorëve të huaj: 271 miliard lek
- impakti në ekonomi i vizitorëve vendas: 80,4 miliard lek

Për vitin 2020, kontributi total i udhëtimeve turistike:

- në raport me PBB-n ka qenë 10.6% e ekonomisë totale.
- në punësim 194.6 mijë të punësuar ose 17,5% e punësimit total.
- impakti në ekonomi i vizitorëve të huaj: 125 miliard lek
- impakti në ekonomi i vizitorëve vendas: 41,5 miliard lek

Sektor i turizmit kulturor ka një potencial të rëndësishëm për shkak të trashëgimisë së pasur historike-kulturore. Megjithatë, trashëgimia kulturore është aktualisht duke u përballur me disa sfida të lidhura me aksesin pranë siteve dhe monumenteve që lidhen me infrastrukturën e dobët për realizimin e ngjarjeve kulturore pranë tyre, si dhe aksesueshmërinë e ulët për personat me mobilitet të ulët. Rajonet me trashëgimi kulturore duhet të adoptojnë teknologjitë digjitale dhe të modernizojnë menaxhimin e siteve.

---

<sup>5</sup> Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, 2019.

Sipas ligjit 2018 për “Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, Shqipëria duhet të ofrojë shërbime në përputhje me objektivat e ruajtjes, menaxhimit, përhapjen, dhe valorizimit të trashëgimisë kulturore. Për këtë duke mundësuar akses në arsim, kulturë, punësim, përdorimin e teknologjive e reja të komunikimit, mjedis dhe përfshirjen e grupeve sociale në mënyrë që të rritet kohezioni social dhe sensi i përkatësisë. Në këto procese duhet të përfshihen aktorë të interesuar në përdorimin e trashëgimisë për zhvillim lokal, si për shembull nga sektori i turizmit (agjenci turistike, tour operator, bujtina, struktura pritëse, bloggerë etj) si dhe nga sektori i industrisë krijuese të lidhur me ngjarjet kulturore, festivalet, dizainin etj, të cilët mund të hapin vende të reja pune, qoftë dhe sezonale.

Duke e konsideruar procesin e digjitalizimit të trashëgimisë si sfidë por dhe si mundësi për të ardhmen, Ministria e Kulturës ka krijuar “Platformën Digjitale” për Sektorin e Trashëgimisë Kulturore, që mund të shfrytëzohet në muzetë në vend.

### Turizmi në Mirditë

Mirdita ka një potencial optimal për të zhvilluar turizmin gjatë gjithë vitit. Ajo gëzon kushte klimatike të përshtatshme, një peizazh të bukur, pyje të gjera, prodhime bujqësore dhe blegtorale. Trashëgimia kulturore dhe etnografike e Mirditës është e pasur dhe e veçantë. Pasuritë kostumografike, muzikore, arkitektonike dhe gjuhësore përbëjnë një pasuri të veçantë. Popullsia lokale është shumë mikpritëse dhe e arsimuar. Natyra dhe kreativiteti i njeriut kanë pajisur Mirditën me një sërë monumentesh natyrore, gjeologjike dhe kulturore. Kullat e lashta qindra vjeçare janë një atraksion për vizitorët e huaj.

Vlejnë për t’u theksuar zonat si Fushë-Lugja, Didha, Mulli dhe Valmori si vende me potencial të lartë për organizimin e lojërave dimërore, si dhe Kroji i Bardhë në Selitë, uji i të cilit ka vlera kurative. Megjithatë, edhe pse potenciali është i madh, përvoja e vizitorëve ndikohet negativisht prej një sërë faktorësh. Infrastruktura rrugore e amortizuar ngadalëson hyrjen në zonat turistike, veçanërisht ato malore. Një pjesë e monumenteve kulturore ka nevojë për mirëmbajtje dhe restaurim. Mungesa e harteve, sinjalistikës dhe informacionit për vende të atraktshme natyrore dhe mungesa e markimit të shtigjeve malore ndikojnë negativisht në përvojën e vizitorëve. Së fundmi, edhe marketingu i territorit është shumë i pamjaftueshëm.

Pikat e forta të turizmit në Mirditë:



- Popullsia e aftë për punë. Bazuar në censusin e 2011 të INSTAT, numri i personave të aftë për punë arrin 14,664, ose 66.3% e popullsisë së bashkisë, me një ndarje të barabartë midis burrave dhe grave.<sup>6</sup> (Afërmendsh, duke marrë në konsideratë ndryshimet demografike të viteve të fundit, nevojitet një census i ri për një pasqyrë më të qartë)
- Trashëgimia kulturore dhe historike. Në Mirditë 11 monumente janë shpallur monumente kulturore të kategorisë I dhe II. Gjithashtu, Mirdita ka shumë monumente natyrore.
- Pozicioni strategjik. Vendndodhja gjeografike pranë Kosovës ofron një potencial të madh për zhvillimin e turizmit, duke qenë se rruga kombëtare që lidh Shqipërinë me Kosovën kalon përmes Mirditës.

Pikat e dobëta të turizmit në Mirditë:

- Mungesa e investimeve domethënëse në këtë sektor dhe mungesa e mbështetjes financiare përgjithësisht.
- Mangësi në promovimin e atraksioneve turistike.
- Interesim i ulët i të rinjve për kontribuar në zhvillimin e turizmit në Mirditë, për shkak të tendencës në rritje të emigracionit drejt qyteteve kryesore ose jashtë vendit.
- Mosshfrytëzim i burimeve ekzistuese për turizmin natyror dhe kulturor.
- Infrastruktura e rënduar pranë monumenteve dhe siteve kulturore.

Mundësitë për zhvillimin e turizmit në Mirditë, sipas Planit Operacional të Strategjisë së Zhvillimit Mirditë:

- Turizmi dhe agrobiznesi mbeten dy sektorë me potencial të rëndësishëm për zhvillimin socio-ekonomik të zonës.
- Aderimi i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe interesimi në rritje i donatorëve ndërkombëtarë ofron mundësi për lëvrime të financimeve të ndryshme.
- Mundësi për thithjen e fondeve nëpërmjet aplikimeve në projekte të fokusuar në turizëm të mbështetura në trashëgiminë kulturore.
- Rritja e interesit të turistëve të huaj për Ballkanin, dhe veçanërisht për Shqipërinë.
- Ndonëse mungojnë kapacitetet për turizëm masiv, ka potencial të konsiderueshëm për të rritur të ardhurat nga aktivitetet e diversifikuara ekonomike, duke shfrytëzuar në mënyrë eficiente burimet natyrore dhe kulturore.

---

<sup>6</sup> Porta Vendore, n.d.

Priortetet e identifikuara për turizmin në Mirditë janë si më poshtë:

- Zhvillimi i zinxhirit të sektorit turistik cilësor dhe të shumëllojshëm për t'a shndërruar në një nga motorët kryesorë të zhvillimit ekonomik në Mirditë.
- Ngritje të kapaciteteve të administratës publike në kuadër të integritimit Evropian, për të përftuar mbështetje financiare të programeve mbështetëse të Bashkimit Evropian
- Kualifikimi i burimeve njerëzore në fushën e menaxhimit të turizmit dhe nxitja e frekuentimit të arsimit profesional në këtë sektor.
- Studimi i nevojave të tregut turistik dhe profilizimi i profesioneve në përputhje me kërkesat e tregut.
- Përmirësimi i infrastrukturës turistike, duke përfshirë sinjalistikën informuese, pikat e informimit, aksesueshmërinë, digjitalizimin, etj.
- Përmirësimi i marketingut të zonës, veçanërisht duke përdorur teknologjitë digjitale.
- Mbështetja e traditave më të mira të artizanatit vendas dhe zhvillimi i tij në funksion të turizmit.
- Mbështetja e sipërmarrjeve në industrisë krijuese (dizajn, teknologji, arkitekturë, etj)
- Organizimi i eventeve kulturore (festivale, koncerte, mbremje poetike, teatër, kinema e hapur, performanca, etj) pranë monumenteve të kulturës.

## METODOLOGJIA

Për përgatitjen e këtij dokumenti, u konsultuan dokumentet politike të realizuara nga partnerët në kuadër të projekteve evropiane të zbatuara më herët, si dhe dokumenti “Strategjia Kulturore e Shqipërisë”, i përgatitur në mars të vitit 2018 në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe Këshillin e Europës.<sup>7</sup>

Gjithashtu, u intervistuan 11 ekspertë (5 gra dhe 6 burra) të turizmit, trashëgimisë kulturore, artizanë e zejtarë, përfaqësues të institucioneve kulturore si Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, Muzeu Etnografik, Shoqata e Artizanatit, Shoqata e Turizmit, operatorë ekonomikë, Organizata të Shoqërisë Civile. Këto intervista shërbyen për identifikimin e problematikave dhe nevojave në terren nga individë që e njohin më së miri zonën. Organizatat partnere, Art Kontakt dhe EcoKult,

---

<sup>7</sup> Kern, P. 2018.

në bashkëpunim me grupet e interesit, zhvilluan një analizë mbi çështjet e lidhura me përvojën e menaxhimit të siteve kulturore, dhe specifiku të sektorit të artizanatit.

Intervistat u fokusuan kryesisht në pikat si më poshtë:

- Promovimi i pasurisë etnografike dhe traditës zejtare të Mirditës;
- Nevojat në kapacitete të institucioneve lokale, kryesisht të Njesisë për Integrim Evropian pranë Bashkisë, për të tërhequr fonde nga programet mbështetëse Evropiane;
- Krijimi e një brand-i turistik bazuar në vecoritë e trashëgimisë kulturore të Mirditës;
- Nxitja e pjesëmarrjes së të rinjve në sektorin e industrisë krijuese.

Ky udhëzues ofron kontribute për politikat publike mbi trashëgiminë, artizanatin si pjesë e kësaj trashëgimie, turizmin duke nxjerrë në pah nevojat specifike të territorit. Po ashtu përfshimë rekomandime për përmirësimin e politikave të përmbledhura në kapitullin e fundit.

Për hartimin e këtij dokumenti, është ndërmarrë një metodologji e hollësishme për të analizuar sfidat dhe potencialet në fushën e trashëgimisë kulturore dhe turizmit në Mirditë. Kjo metodologji përfshin një sërë hapash të rëndësishëm që synojnë të grumbullojnë dhe përçojnë informacionin më të rëndësishëm dhe të dobishëm për përgatitjen e këtij dokumenti politikash.

Hapi i parë i metodologjisë ishte njohja me dokumentacionin dhe burimet e disponueshme (desk research) që lidhen me trashëgiminë kulturore, artizanatin dhe turizmin në zonën e Mirditës. Ky hulumtim është bërë nëpërmjet studimit të dokumenteve zyrtare, raporteve të publikuara dhe burimeve të tjera të shkruara që kanë relevancë për temën. Mëtej u realizuan intervista me ekspertë të ndryshëm të fushave të turizmit, trashëgimisë kulturore dhe të kulturës lokale, nëpërmjet të cilave ka grumbulluar njohuri të thella mbi situatën aktuale në Mirditë. Këtu përfshihen ekspertët nga Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, Muzeu Etnografik, Shoqata e Artizanatit, Shoqata e Turizmit, operatorë ekonomikë dhe Organizatat e Shoqërisë Civile.

Hapi i mëtejshëm ishte analiza e çështjeve që lidhen me menaxhimin e siteve kulturore dhe artizanatin në Mirditë, duke u bazuar te burimet dhe informacioni i mbledhur. Në fazën e fundit të metodologjisë, u përgatitën rekomandime të politikave publike në bazë të të dhënave dhe informacioneve të grumbulluara gjatë hapësirës së hulumtimit dhe studimit. Ky dokument i politikës është prodhim i një pune të përbashkët dhe synon të ofrojë një kontribut në zhvillimin e politikave të qëndrueshme dhe efektive në këto fusha në Mirditë.

## TRASHËGIMIA KULTURORE

Nuk ka ndonjë përkufizim të veçantë të trashëgimisë kulturore sot. Sidoqoftë, ekziston një dakordësi globale që vlerat e trashëgimisë vazhdimisht evoluojnë, veçanërisht bazuar në njohjen e rëndësisë së trashëgimisë kulturore nga shoqëritë njerëzore. Trashëgimia kulturore ndahet në dy kategori: trashëgimi materiale dhe jomateriale (apo ndryshe shpirtërore)

Sipas përkufizimit të UNESCO-s "Trashëgimia kulturore është trashëgimia dhe identiteti jonë kulturor që përcillet në brezat e ardhshëm. Elementët materialë, si monumentet, ndërtesat historike dhe sitet natyrore konsiderohen pjesë e trashëgimisë tonë. Elementë jomaterialë, si tradita zakonore, muzika popullore dhe vallet, gjithashtu përbëjnë trashëgiminë tonë kulturore."<sup>8</sup>

Një përkufizim i mirëpërmbledhur i trashëgimisë jepet në nenin 2 të Konventës Faro të vitit 2005: "burime të trashëguara nga e kaluara, të cilat njerëzit i identifikojnë, pavarësisht nga pronësia, si pasqyrë dhe shprehje të vlerave, besimeve, njohurive dhe traditave vazhdimisht në evoluim. Ajo përfshin të gjitha aspektet rrethore që vijnë nga ndërveprimi midis njerëzve dhe vendeve në raport me kohën."<sup>9</sup>

Një nga ekspertët e trashëgimisë kulturore më të njohur në botë, David Loventhal, ka trajtuar këtë marrëdhënie komplekse të procesit të vazhdueshëm dhe thelbësisht të rëndësishëm për çdo komunitet dhe person në përkufizimin e tij të trashëgimisë kulturore, i cili thekson rëndësinë e trashëgimisë në botën aktuale të globalizmit, konflikteve, presioneve të zhvillimit dhe migrimit. Për akademiken dhe studiuesen Barbara Kirshenblatt-Gimblett, trashëgimia kulturore përfaqëson një burim nga e kaluara, që është "i vjetër", por që merr një "jetë të dytë" (që do të thotë se do të ketë funksion të ri si "trashëgimi") dhe atribuohet si vlerë e posaçme nga shoqëria ("e çmuar", "e rrallë", "në zhdukje").<sup>10</sup>

Trashëgimia Kulturore konsiderohet si një burim i çmuar për rritjen ekonomike, punësimin, kohezionin social dhe eliminimin e pabarazive sociale, fetare dhe politike ndarje të cilat na lejojnë gjithashtu të reflektojmë dhe ta shohim me sy kritik historinë, duke na ndihmuar të identifikojmë kujtime të ndryshme dhe të përbashkëta, fjetet e te cileve na lidhin të gjithëve. Në Evropë njihet si një burim që promovon diversitetin, dialogun, kohezionin, solidaritetin dhe mirëkuptimin reciprok. Pavarësisht nëse është materiale apo jomateriale, trashëgimia kulturore është unike

---

<sup>8</sup> Instituti i Statistikave UNESCO, 2009.

<sup>9</sup> Këshilli i Evropës, 2005.

<sup>10</sup> OSBE, 2020.

dhe e çmuar, ndaj dhe shoqëritë duhet t'a ruajnë, t'a mbrojnë dhe t'ia përcjellin brezave të ardhshëm.

Nisur nga karakteristikat specifike të trashëgimisë kulturore, për menaxhimin e saj është e nevojshme që të gjithë të kujdesemi për njohjen dhe ruajtjen, dhe aty ku është e mundur, të gjenerohen të ardhura ekonomike në ndihmë të komuniteteve rreth saj.

Shumë qytete, rajone dhe vende në botë e mbështesin zhvillimin e tyre turistik bazuar në trashëgiminë kulturore. Për shumicën e destinacioneve turistike në botë, trashëgimia mbetet një element kyç i ofertës turistike që ata mund t'u prezantojnë turistëve, dhe si e tillë shihet si avantazh konkurrues. Trashëgimia kulturore, pra, kontribuon në pasurimin e ofertës turistike të një territori të tërë, një qyteti, një rajoni, dhe një vendi të tërë. Për të paktën dy dekada, në Evropë muzetë kanë kaluar një fazë të transformimeve të thella që kanë impaktuar proceset e zhvillimit të territorit ku ato ndodhen. Një zhvillim i kohëve të fundit është fuqizimi i teknologjive të reja digjitale në muze, si dhe përdorimi i tureve virtuale. Rekomandimet për përmirësimin e standardeve dhe performancës ekonomike të muzeve në botë janë bazuar kryesisht në udhëzimet e Këshillit Ndërkombëtar për Monumentet dhe Sitet (ICOMOS).<sup>11</sup>

### Politikat e Bashkimit Evropian për Trashëgiminë Kulturore

Në prill 2015, Ministrat e Shteteve Palë në Konventën Evropiane të Kulturës u takuan duke miratuar “Deklaratën e Namurit”<sup>12</sup> për të promovuar një qasje të përbashkët dhe unifikuese për menaxhimin e trashëgimisë kulturore për shekullin e 21 bazuar në këto 3 modele:

1. Ekonomik: bëhet një model që ka një ndikim pozitiv në krijimin e vendeve të punës;
2. Social: favorizon integrimin, gjithëpërfshirjen, kohezionin dhe pjesëmarrjen shoqërore;
3. Mjedisor: trashëgimia kulturore mundëson zhvillim të qëndrueshëm dhe ruajtjen e peizazheve. (rasti par-excellence në Shqipëri, siti i Butrintit).

Kur bëhet fjalë për bazën ligjore për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, tashmë ajo përfshihet në dy nga tre dokumentet themelore të BE-së. Trashëgimia kulturore përmendet në nenin (3) të “Traktatit të Bashkimit Evropian” që thekson se BE do të garantojë që trashëgimia kulturore e Europës të mbrohet dhe vlerësohet. Trashëgimia kulturore po ashtu përmendet në nenin 167 të “Traktatit për Funkcionimin e Unioni Evropian”, ku përcakton rolin e BE-së në këtë fushë që

---

<sup>11</sup> <https://www.icomos.org>

<sup>12</sup> Këshilli i Bashkimit Evropian. 2015.

inkurajon bashkëpunimin ndërmjet shteteve anëtare, dhe nga ana tjetër mbështet njohjen dhe përhapjen e kulturës dhe historisë të popujve ende jo anëtarë me trashëgimi kulturore të rëndësishme Evropiane.

Një nga dokumentet më të rëndësishme në lidhje me trashëgiminë kulturore është "Agjenda e re Evropiane për Kulturën", neni 3 i Traktatit për Bashkimin Evropian dhe Neni 167 i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian. Te "Agjenda e Re" ka tre objektiva strategjike të cilët kanë në fokus dimensionin social, ekonomik. Në dimensionin social, theksohet "Përdorimi i fuqisë të kulturës dhe diversitetit kulturor për kohezionin dhe mirëqënien sociale".

Gjatë vitit 2018, viti Evropian i Trashëgimisë Kulturore, u publikua dokumenti me Planin e Punës për Kulturën 2019-2022<sup>13</sup>, një nga qëllimet e të cilit ishte përcaktimi i një linje të përbashkët për aktivitetet e lidhura me trashëgiminë Evropiane, kryesisht përmes politikave dhe programeve mbështetëse të BE-së. Ishte parashikuar të shërbente si pikë reference për rajonet dhe qytetet në Evropë, si dhe për organizatat dhe rrjetet e trashëgimisë.

### **Konventat ndërkombëtare mbi Trashëgiminë Kulturore që janë ratifikuar nga Shqipëria**

#### **1. Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, Paris, 2003**

Kjo Konventë adreson a) ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale; b) respektimin e trashëgimisë kulturore jomateriale të bashkësive, të grupeve dhe të individëve të prekur; c) sensibilizimin në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar për rëndësinë e trashëgimisë kulturore jomateriale dhe të vlerësimit të saj të ndërsjellë; d) bashkëpunimin dhe asistencën ndërkombëtare.<sup>14</sup>

#### **2. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkeologjike, Paris, 1954**

Kjo Konventë adreson mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike si një burim i kujtesës kolektive evropiane, dhe si një mjet për studime historike dhe shkencore. Për këtë qëllim, elemente të trashëgimisë arkeologjike konsiderohen të gjitha rrënojat, objektet dhe çdo gjurmë tjetër e njerëzimit nga epokat e kaluara.<sup>15</sup>

#### **3. Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Nënujore, Paris, 2001**

---

<sup>13</sup> Këshilli i Bashkimit Evropian, 2018.

<sup>14</sup> Ligji nr. 9490, datë 13.3.2006

<sup>15</sup> Ligj Nr. 9807, datë 17.9.2007

Kjo Konventë synon të forcojë mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nënujore. Shtetet Palë bashkëpunojnë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nënujore.<sup>16</sup>

### Kuadri ligjor i trashëgimisë kulturore në Shqipëri

Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019 -2025 është hartuar në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga programi i Qeverisë Shqiptare dhe angazhimeve të ndërmarra nga Ministria e Kulturës në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian.<sup>17</sup>



Marrë nga faqja zyrtare e Ministrisë të Kulturës, Elva Margariti.

Plani Shoqëruar i Veprimit synon konceptimin e një udhërrëfyese për zhvillimin e sektorit të kulturës, trashëgimisë kulturore dhe industrisë krijuese, me qëllim krijimin e kushteve të favorshme për zhvillim publik, social dhe privat.

Hartimi i dokumentit ka ndjekur metodologji gjithëpërfshirëse duke u bazuar në vlerësimin e grupeve të interesit nga sektori publik dhe privat, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare që veprojnë në fushën e kulturës, artit dhe trashëgimisë kulturore në Shqipëri, si dhe në mbështetjen e ekspertëve vendas dhe të huaj të fushës, me synimin e ofrimit të zgjidhjeve të qëndrueshme për sfidat sektoriale drejt misionit që kultura të bëhet faktor i rëndësishëm zhvillimi

ekonomik dhe social për qytetarët shqiptarë.

Vizioni i Strategjisë Kombëtare të Kulturës është: "Trashëgimia kulturore e Shqipërisë, forcë shtytëse për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror të vendit veçanërisht për sa i përket turizmin kulturor." Në kushtet kur turizmi shqiptar ka një rritje të jashtëzakonshme pas krizës së pandemisë Covid-19, kjo rritje e fluksit turistik është shoqëruar dhe me një rritje të vizitorëve pranë kalave, monumenteve, parqeve arkeologjike dhe siteve të tjera kulturore.

<sup>16</sup> Ligji nr. 10 027, datë 11.12.2008

<sup>17</sup> Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019-2025

Misioni i Strategjisë Kombëtare të Kulturës është: “Krijimi i mjedisit të favorshëm për rritjen dhe zhvillimin e shërbimeve dhe produkteve kulturore dhe krijuese në sektorin publik dhe privat.”

Për realizimin e vizionit dhe misionit të paraqitur në këtë dokument strategjik, Ministria e Kulturës ka përcaktuar qëllimin strategjik “Më shumë vëmendje për artin dhe kulturën”, që ndërlidhet fort me objektivat specifike dhe masat e planifikuara për jetësimin e tyre. Janë identifikuar pesë objektiva specifike që synojnë përmbushjen e qëllimeve strategjike, si vijon:

1. Përmirësimi dhe zgjerimi i tregjeve kulturore përmes legjislacionit, prej të cilave do të përfitojnë krijuesit, industristria krijuese vendase si dhe trashëgimia kulturore;
2. Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale;
3. Nxitja dhe përfaqësimi i vlerave kulturore të arteve dhe trashëgimisë kulturore (materiale dhe jomateriale) shqiptare në aktivitete të rëndësishme ndërkombëtare dhe prezantimi i praktikave më të mira;
4. Mbështetje e krijimtarisë së artistëve shqiptarë dhe shtimi i veprimtarive kulturore dhe artistike;
5. Hartimi dhe zbatimi i një platforme arsimore përmes institucioneve të artit dhe trashëgimisë kulturore dhe sistemit parauniversitar.

Strategjia për trashëgiminë kulturore në Shqipëri është hartuar duke pasur parasysh gjendjen e sektorit të kulturës në Republikën e Shqipërisë, karakteristikat dhe vlerat themelore të saj, problematikën e krijuar ndër vite dhe nevojën për gjetjen e zgjidhjeve optimale. Ajo është hartuar në përputhje me standardet evropiane të zhvillimit të kulturës dhe reflekton përvojën e krijuar në BE në fushën e hartimit dhe zbatimit të strategjive kulturore të vendeve evropiane.

Dokumenti strategjik SKK 2019-2025 u drejtohet institucioneve publike qendrore dhe lokale, operatorëve të pavarur kulturorë, OJF-ve, sektorit privat dhe aktorëve të tjerë që operojnë në fushën e kulturës dhe trashëgimisë kulturore.

Në vitin 2018, Kuvendi miratoi Ligjin nr. 27/2018 për Kulturën, Trashëgimia dhe Muzetë, që synon ndër të tjera të realizojë reforma të thella në menaxhimin e trashëgimisë kulturore dhe muzeve. Ligji nr. 27/2018 përcakton kornizën e trashëgimisë kulturore shqiptare, e cila përbëhet nga pasuritë dhe vlerat materiale dhe jo materiale. Instituti i Monumenteve të Kulturës, Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore, Instituti Arkeologjik, Instituti i Kulturës Popullore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivit Shtetëror janë përgjegjëse në fushën e mbrojtjes e trashëgimisë kulturore kombëtare.



Në fillim të vitit 2014 u formua një sistem i ri i administrimit territorial të "Aseteve të Trashëgimisë tonë Kulturore Kombëtare" nëpërmjet krijimit të 6 Drejtorive Rajonale të Kulturës Kombëtare, të cilat ishin: 1) DRKK-Shkodër, 2) DRKK-Durrës, 3) DRKK-Berat, 4) DRKK-Vlorë, 5) DRKK-Gjirokastrë dhe 6) DRKK-Korçë. Institucionet e lartpërmendura u ristrukturuan në vitin 2018 në bazë të një projektvendimi të ri, i cili ka për qëllim miratimin e mënyrës së funksionimit dhe zhvillimit të veprimtarisë së 6 DRTK-ve. Çdo DRTK në fjalë ka për mision gjurmimin, hulumtimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, inspektimin, publikimin dhe promovimin e Trashëgimisë Kulturore Materiale, në territorin që mbulon.

DRTK-Shkodër mbulon të gjithë Shqipërinë e Veriut, përfshirë rrethin Mirditë. DRTK-Shkodër administron e vetme plot 10.109 km<sup>2</sup> ose 35 (35.16)% të territorit. Këtu përfshihen 4 Qarqe: Shkodër, Lezhë, Kukës e Dibër, dhe 15 Bashki: Shkodër, Vau i Dejës, Malësi e Madhe, Pukë, Fushë-Arrëz, Lezhë, Mirditë, Kurbin, Kukës, Bajram Curri, Has, Dibër, Bulqizë, Mat e Klos.

### Trashëgimia kulturore në Mirditë

Mirdita është një zonë me shumë pasuri të trashëgimisë kulturore, të cilat është e rëndësishme t'i vlerësojmë, ruajmë dhe promovojmë për brezat e ardhshëm. Ky territor është i pasur me trashëgimi materiale dhe jomateriale, duke përfshirë monumente historike, tradita të lashta, dhe zhanre artistike unike që janë ndërthurur me kulturën dhe jetën e komunitetit mirditor.

Ndër pasuritë më të njohura të Mirditës janë objektet arkitekturore tradicionale, ku përfshihen shtëpitë e gurta me çati gurësh, kisha të lashta dhe objekte të tjera arkitektonike me vlera historike. Kisha e Manastirit të Rubikut është një prej kishave më të njohura të zonës, me origjinë të hershme dhe histori të veçantë, duke qenë se këtu kanë shërbyer disa nga emrat më të shquar të kulturës dhe letërsisë shqiptare, si At Gjergj Fishta, At Shftjefën Gjecovi, etj. Gjithashtu, Mirdita është e njohur për artin e gdhendjes së drurit dhe gurit dhe punimin e veglave muzikore tradicionale si çiftelia dhe lahuta. Këto trashëgimi artistike janë pasuri e çmuar e kësaj zone dhe përbëjnë një pjesë të thellë të identitetit të saj kulturor.

Megjithatë, ndryshimet në strukturën shoqërore dhe prirjet e reja të jetës kanë sjellë sfida në ruajtjen dhe pasurimin e kësaj trashëgimie. Prirjet drejt qyteteve dhe emigrimi i lartë kanë bërë që artizanët e rinj të mos i vazhdojnë më aktivitetet tradicionale si gdhendja e drurit, punimi i gurit, punimi i veglave muzikore, etj. Kjo është arsyeja pse është thelbësore të angazhohemi në aktivitete informuese dhe edukative për të rinjtë dhe të rejtat e Mirditës. Duke i njohur ata me trashëgiminë kulturore të zonës dhe duke i frymëzuar ata për të ndjekur këto tradita, mund të

sigurojmë që vlerat unike të kësaj zone jo vetëm do të mbijetojnë, por edhe do të rijetësohen nga brezat e ardhshëm.

Organizatrat që operojnë në Mirditë, si "Qendra San Luixhi", "Qendra Caritas", "Shoqata e Grave Mirditore", dhe "Fondacioni për Zhvillimin e Mirditës", kanë një rol të rëndësishëm në këtë mision të ruajtjes së trashëgimisë kulturore. Bashkëpunimi dhe angazhimi i tyre në promovimin dhe mbrojtjen e kësaj pasurie është i çmuar për të siguruar që Mirdita do të mbetet një thesar i kulturës dhe trashëgimisë sonë kombëtare.

Një tjetër aspekt i spikatur i kulturës mirditore është dasma tradicionale mirditore dhe detajet e saj të pazakonshme që e dallojnë atë nga dasmat e tjera të vendit. Mirdita gjithashtu njihet për folklorin e pasur, ku këngët e kreshnikëve dhe baladat e qëmotshme zbresin nga brez pas brezi nëpër kohë. Vallja e famshme e "Gurrës së Lashtë", me motive që zënë fill mbi historinë e gurrës së lashtë të Domgjonit, është një shembull i rrallë i trashëgimisë koreografike të Mirditës, ku motive historike ndërthuren me ekspresionin artistik. Valle të tjera të rëndësishme janë "Skifteri dhe pëllumbesha", "Vallja katërshe e Zajsit", etj.

Pasuria kulturore e Mirditës shtrihet edhe në artin e punës së drurit, duke përfshirë gdhendjet e dekorimeve dhe të veglave muzikore tradicionale si çiftelia dhe lahuta. Punimet e artizanëve vendas në gurë dhe gdhendjet dekorative të drurit dekoronin shtëpitë dhe tavanet tradicionale. Gjithashtu krijimi i instrumenteve muzikore tradicionale, si tatiragja, pipëza, cingona, pizare, pingare, zile, këmborë, polike, guralecë, kusi, tepsi, shoshë, hutë, gjeth, kavalli, fyelli, bilbili, çiftelia dhe lahuta, përfaqësuesja e arketipit më të lashtë të veglave kordofone me hark në Mirditë, është i përhapur në këtë rajon. Instrumentet janë pasuri e trashëgimisë kulturore të kësaj treve dhe kanë një rol të rëndësishëm në identitetin kulturor të komunitetit mirditor. Këto trashëgimi artizanale janë të veçanta për Mirditën dhe duhet të ruhen dhe promovohen me kujdes për t'u siguruar që të mos humbasin.

Gjithashtu, eventet kulturore që organizohen në kuadër të ditëve të trashëgimisë kulturore dhe evente të përvitshme për promovimin e turizmit janë të shumta. Duke qenë se Mirdita është një zonë me përkatësi fetare kryesisht katolike, festat fetare zënë një vend të rëndësishëm, ku përmendim festa e Shën Mëhillit, Shën Ndojit, etj.

## NEVOJAT DHE PRIORITETET

### Intervistat

Intervistat e zhvilluara me zejtarë dhe përfaqësues të sektorit të trashëgimisë kulturore dhe turizmit kulturor dhe natyror të zonës sollën në vëmendje nevojat, prioritetet dhe problematikat që duhen kapërcyer për t'a bërë Mirditën më tërheqëse dhe konkurruese në aspektin turistik. Gjatë intervistave<sup>18</sup> dolën në pah nevojat e mëposhtme:

- Krijimi i një ekosistemi të qëndrueshëm duke harmonizuar të gjitha hallkat e ekonomisë lokale.
- Rritja e kapaciteteve të aktorëve lokalë, institucioneve, apo organizatave të shoqërisë civile për të tërhequr fonde në fushën e kulturës nga programet e ndryshme Evropiane.
- Nxitja dhe mbështetja e sipërmarrjeve të reja kulturore.
- Promovimi i pasurisë etnografike të Mirditës bazuar në përdorimin e teknologjive digjitale.
- Promovimi i ekoturizmit dhe shtigjeve natyrore.
- Restaurimi, mirëmbajtja e kullave dhe kthimi i tyre në bujtina për vizitorët dhe turistët.
- Përdorimi i mediave sociale, të cilat mbështesin dhe përmirësojnë funksionet e faqeve të internetit institucionale dhe rrisin kapacitetin e profilizimit të përdoruesve dhe shtimin e vizitorëve virtualë.
- Krijimi dhe aktivizimi i dialogut konstruktiv me Ministrinë e Kulturës, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Turizmit, etj. në promovimin e zonës.
- Krijimi i një brand-i turistik bazuar në elementët e trashëgimisë kulturore të Mirditës.
- Përfshirja e të rinjve në procesin e valorizimit të trashëgimisë kulturore përmes ngjarjeve kulturore pranë monumenteve.

### Analiza SWOT

A. Pika të forta:

- Trashëgimi kulturore e larmishme dhe me një ndjenjë të fortë përkatësie nga komunitetet vendase.
- Prodhuesit e sektorit të zejeve tregojnë se kanë baza të forta teknike të konsoliduara nga përvoja e gjatë në këtë fushë.
- Aktivitetet prodhuese të sektorit të zejeve janë të pranishme në të gjithë zonën.

---

<sup>18</sup> Lista e të intervistuarve përfshihet në Shtojcën A.

- Ka një legjislacion nxitës nga ana e Qeverisë (kryesisht përmes Ministrisë e Kulturës dhe Turizmit) për mbështetjen e trashëgimisë kulturore në funksion të zhvillimit lokal dhe turizmit.
- Projektet e financuara nga BE-ja trajtojnë çështjen ruajtjes së identitetit dhe valorizimit të trashëgimisë kulturore në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal përmes përdorimit të teknologjisë digjitale dhe një menaxhimi modern.
- Njohja e vlerës sociale të industrisë kreative, kryesisht dizajnit modern bazuar në elemente të traditës, është në rritje.

#### B. Pika të dobëta:

- Fragmentimi i aktiviteteve kulturore, duke përfshirë edhe nivel lokal. Mungon një strategji me një kalendar të harmonizuar dhe një ofertë turistike më të gjerë (turizëm kulturor, turizëm malor, turizëm kulinarie, turizëm mjekësor, etj.)
- Kapacitet i kufizuar për sipërmarrje kulturore, promovim dhe marketing të produkteve kulturore të territorit.
- Mungesa e kapaciteteve për të shkruajtur projekte dhe siguruar mbështetje financiare nga organizatat që mbështesin nismat kulturore.
- Sezonaliteti i flukseve turistike, që nënkupton një ekonomi të limituar.
- Burime të pakta të disponueshme financiare dhe profesionale për investime në sektorin e industrisë krijuese (dizajn, multimedia, teknologji informacioni etj).
- Koordinim i dobët ndërmjet operatorëve të trashëgimisë kulturore dhe operatorëve turistikë në nivel lokal.
- Burime publike financiare të vogla për investime në fushën e turizmit kulturor.
- Ngadalësimi në adoptimin e inovacionit teknologjik në menaxhimin e trashëgimisë kulturore (muze, sitet kulturore).
- Mungesa e ndërgjegjësimit të publikut për përfitimet ekonomike, potencialet dhe rëndësinë e kulturës dhe krijimtarisë.
- Mungesa të Partneritetit Publik Privat në fushën e menaxhimit të trashëgimisë kulturore.

#### C. Mundësi:

- Krijimi i një ekosistemi bazuar në identitetin e territorit dhe në menaxhimin inovativ të burimeve ekzistuese.
- Zhvillimi i industrisë krijuese bazuar në elementë të traditës të zonës.

- Strategji dhe nisma kulturore që nxisin përdorimin më eficient të teknologjive digjitale për përmirësimin e marketingut territorial dhe promovimin e turizmit të përvojës.
- Bashkëpunim më i madh ndërsektorial të sektorëve të arsimit, sektorit prodhues, tregtisë.
- Kontributi i shoqërisë civile dhe media lokale në sensibilizimin dhe edukimin e të rinjve me vlerat e trashëgimisë kulturore.
- Aftësitë e të rinjve në përdorimin e teknologjive të reja në fushën e valorizimit trashëgimisë kulturore.
- Bashkëpunimi ndërmjet aktorëve lokalë si dhe ndërmjet tyre dhe rrjeteve ndërkombëtare të turizmit kulturor si për shembull krijimi i itinerarëve kulturorë me vendet e rajonit.<sup>19</sup>

#### D. Rreziqe:

- Nxitimi drejt teknologjive të informacionit gjithnjë e më të sofistikuar, të paarrtshme për punonjësit e industrisë kreative dhe kulturore.
- Rritja e menjëhershme e kërkesës turistike dhe mungesa e kapaciteteve akomoduese.
- Ndryshimi ose humbja e identitetit vendas ose stilit të jetesës së komuniteteve vendase.
- Humbja e interesit ndaj traditës tek të rinjtë.
- Mosadoptimi i saktë i dokumenteve strategjike zhvillimore.
- Reagimi i pamjaftueshëm dhe joeficient i autoriteteve publike ndaj krizave, psh si ajo e Covid-19.
- Mjedis i paqëndrueshëm ekonomik, politik dhe social.
- Përjashtimi i grupeve të interesit të sektorit të kulturës nga proceset e vendimmarrjes.
- Mungesa e incentivave për tregun turistik dhe kulturor nga sektori publik.
- Kërcënimi i lirive artistike dhe krijuese.
- Mosrespektimi i të drejtës intelektuale dhe krijuese.

#### Rekomandime për përmirësimin e politikave publike

Nga hulumtimet dhe analizat e përshkruara në këtë dokument, rekomandimet e politikave publike sintetizohen si më poshtë:

1. Harmonizimi i politikave publike në nivel kombëtar dhe lokal.
2. Ndihma për zejtarët dhe artizanët e Mirditës për t'u integruar më mirë në tregjet rajonale dhe për të rritur kapacitetet e krijimtarisë së tyre. Kjo mund të arrihet përmes krijimit të një fondi

<sup>19</sup> Për shembull, rasti i shembujve të itinerarëve të Këshillit të Europës. Link: <https://www.coe.int/en/web/cultural-routes>

të veçantë për artizanët që mbështet investimet e vogla në vegla, materiale, dhe teknologjinë e nevojshme për të rritur cilësinë dhe rendimentin punës. Gjithashtu, artizanët mund të përfitojnë nga asistenca për regjistrimin në Drejtorinë e Patentave e modeleve të krijimeve të tyre artistike artizanale.

3. Përdorimi i teknologjisë digjitale dhe përmirësimi i menaxhimit në site dhe vende të trashëgimisë kulturore të Mirditës. Për këtë nevojitet edhe trajnimi i guidave dhe ciceronëve vendas që të ofrojnë udhëtime turistike kulturore dhe udhëtime turistike të përvojës artizanale në Mirditë.
4. Rritje e kapaciteteve përthithëse të fondeve të zejtarëve dhe artizanëve në sektorin e trashëgimisë kulturore dhe industrisë krijuese dhe kreative. Për këtë do të ndihmojë krijimi i një platforme lokale ku identifikohen grante dhe programe të përshtatshme që mund të ndihmojnë në zhvillimin e aktiviteteve të tyre.
5. Nxitja e komunikimit midis institucioneve publike dhe qytetarëve përmes fushatave sensibilizuese, takimeve, prezantimeve në hapësira publike të produkteve kulturore, etj, për të rritur vetëdijen mbi rëndësinë e trashëgimisë kulturore.
6. Mbështetja e organizatave kulturore në gjallërimin e monumenteve të kulturës përmes aktiviteteve kulturore pranë tyre.
7. Forcimi i rolit të shoqërisë civile në zbatimin e projekteve që përfshijnë grupet e marginalizuara në zhvillimin ekonomik-social të zonës.
8. Nxitja e formave inovative të Partneriteti Publik Privat në fushën e shërbimeve në sektorin e trashëgimisë kulturore. Për shembull disa shërbime si ciceron, guida, marketing, shkrime projekte etj mund të realizohen nga profesionistë dhe organizata jo-fitimprurëse prezente në zonë.
9. Nxitja, edukimi dhe përfshirja e të rinjve në promovimin e trashëgimisë, duke i afruar pranë monumenteve. Kjo mund të realizohet përmes organizimit të programeve edukative mbi historinë dhe zejtarinë e zonës dhe të Shqipërisë në shkollat vendore.

## REFERENCA

- Bashkia Mirditë. 2016. Plani operacional i zhvillimit vendor. Marrë nga: <https://portavendore.al/wp-content/uploads/2018/11/Bashkia-Mirdite-compressed.pdf>
- Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore. 2018. Lista e Monumenteve të Kulturës – Qarku Lezhë. Marrë nga [http://iktk.gov.al/site/wp-content/uploads/2020/10/Monumentet\\_-Qarku-Lezhe.pdf](http://iktk.gov.al/site/wp-content/uploads/2020/10/Monumentet_-Qarku-Lezhe.pdf)
- Instituti i Statistikave. (n.d.). Treguesit Demografikë dhe Socialë | Instat. Marrë nga: <https://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografike-dhe-socialë/>
- Instituti i Statistikave UNESCO. 2009. 2009 UNESCO Framework for Cultural Statistics.
- Këshilli i Bashkimit Evropian. 2015. Deklarata e Namurit. Marrë nga: <https://rm.coe.int/16806a89ae>
- Këshilli i Bashkimit Evropian. 2018. Plani i punës për Kulturën 2019-2022. Marrë nga: <http://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-13948-2018-INIT/en/pdf>
- Këshilli i Evropës. 2005. Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Vlerën e Trashëgimisë Kulturore për Shoqërinë. Marrë nga: <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806ae695>
- Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. 2006. Ligj Nr. 9490, datë 13.3.2006 "Për ratifikimin e Konventës për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, Paris 2003." Marrë nga: [https://www.kultura.gov.al/wp-content/uploads/2017/12/Ligji\\_nr.\\_9490.pdf](https://www.kultura.gov.al/wp-content/uploads/2017/12/Ligji_nr._9490.pdf)
- Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. 2007. Ligj Nr. 9807, datë 17.9.2007 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Europiane 'Për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkeologjike' (të rishikuar)." Marrë nga: [https://kultura.gov.al/wp-content/uploads/2017/12/LIGJ\\_nr.\\_9806\\_dt\\_17.9.2007\\_web.pdf](https://kultura.gov.al/wp-content/uploads/2017/12/LIGJ_nr._9806_dt_17.9.2007_web.pdf)

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. 2009. Ligj Nr. 10 027, datë 11.12.2008 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Nënujore, Paris 2008." Marrë nga: [https://kultura.gov.al/wp-content/uploads/2017/12/LIGJ\\_nr.10\\_027\\_dt\\_11.12.2008\\_web.pdf](https://kultura.gov.al/wp-content/uploads/2017/12/LIGJ_nr.10_027_dt_11.12.2008_web.pdf)

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. 2018. Ligj Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë." Marrë nga: [https://www.bksh.al/bksh/Ligje/Ligji.nr27-\\_dt.17-05-2018.pdf](https://www.bksh.al/bksh/Ligje/Ligji.nr27-_dt.17-05-2018.pdf)

Ministria e Kulturës. 2019. Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019-2025. Marrë nga: <https://www.kultura.gov.al/programi-i-kultures-2019-2025/>

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. 2019. Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2019-2023. Marrë nga: <https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2019/06/Strategjia-Komb%C3%ABtare-e-Turizmit-2019-2023.pdf>

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. 2022. Flukset e turistëve të huaj, Organizata Botërore e Turizmit rendit Shqipërinë të parën në Europë dhe të dytën në rang global. Marrë nga: <https://turizmi.gov.al/flukset-e-turisteve-te-huaj-organizata-boterore-e-turizmit-e-rendit-shqiperine-te-paren-ne-europe-dhe-te-dyten-ne-rang-global/>

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. 2020. Udhëzues për standardet e hartimit të planeve menaxhuese të trashëgimisë kulturore. Marrë nga: <https://www.osce.org/files/f/documents/f/5/461191.pdf>

Porta Vendore, n.d. Pasaporta e Bashkisë Mirditë. Marrë nga: <https://portavendore.al/bashkia-mirdite/pasaporta-e-bashkise-mirdite/>

Kern, P., 2018. A Cultural Startegy for Albania [Një strategji kulturore për Shqipërinë]. Marrë nga: <https://rm.coe.int/a-cultural-strategy-for-albania-implanting-the-cultural-bug/1680794665>



---

## **PROJEKTI CULTOUR**

### **LISTA E TË INTERVISTUARVE**

**Albert Mëlyshi, Kryetar i Bashkisë Mirditë**

**Gjergj Marku, Publicist**

**Nik Nikolla, Infokulla Mirdita/Bashkia Mirditë**

**Gjokë Pepa, Piktur/ Muzeu Historik i Mirditës**

**Gjovalin Marfana, Specialist/Bashkia Mirditë**

**Drane Fizi, Artizane**

**Gezim Pershqeva, Artizan**

**Adelina Pepkola, Artizane**

**Mirela Pepkola, Artizane**

**Anila Vokri, Artizane**

**Borana Pepa, Shoqëri Civile**

**Martin Gjonaj, Operator turistik**

**Saimir Boka, Ekspert Turizmi**

**Joana Kacorri, Stiliste/themeluese 'Amargi'**

**Everest Ndreca, Kompozitor/muzikant**

**Gerta Loku Tushaj, Prodhuese e produkteve ushqimore/aktiviste**

**Adnand Lleshaj, Poet**

**Autor: Saimir Boka, Ekspert i ekonomisë dhe turizmit**

**Bashkëautor: Andi Tepelena ( Ekspert Politika Kulturore), Inesa Sulaj ( Eksperte muzeologjie)**